

RAPORTI VJETOR 2022

Një vit i transformimeve
të mëdha



Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur

Imzot Nike Prela vila 13 10000 Prishtina Kosovo

Telefon: + 383 38 542 157

Email: info@kfos.org

www.kfos.org



1. HYRJJE

Viti 2022 u shënua nga trazira globale që nxorën në shesh urgjencën e punës që po bëhet nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur në tërë botën. Pushtimi rus i Ukrainës dhe kriza e sigurisë dhe energjisë që pasoi e preku tërë kontinentin evropian, duke e shtyrë Bashkimin Evropian të ndërmarrë hapa të shpejtë për ta pranuar një ndryshim në marrëdhëniet globale dhe nevojën për t'i mbajtur vendet partnere më afër. Si rezultat, vendet anëtare të BE-së ndërmorën hapa të shpejtë për t'ua dhënë statusin e kandidatit Ukrainës dhe Moldavisë, për t'i hapur bisedimet me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, për t'ia dhënë statusin e kandidatit Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe në fund për ta aprovuar liberalizimin e vizave për Kosovën.

Në këtë sfond politik, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur vazhdoi përfshirjen e vet të thellë në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe të një shoqërie të hapur në Kosovë përmes mbështetjes së nismave drejt reformave evropiane dhe bashkëpunimit rajonal, integritit të pakicave etnike dhe zbatimit të Agjendës së Gjellbër. Ashtu si viteve të mëparshme, Fondacioni ishte i përfshirë drejtpërdrejt në debate të politikave duke mbështetur publikime të shumta të hulumtimeve dhe dokumenteve të politikave, duke organizuar debate të mbyllura dhe publike me palë të ndryshme të interesit dhe duke avokuar për ndryshime në nivele të shumta të qeverisjes. Më e rëndësishmja, Fondacioni vazhdoi mbështetjen e tij për shoqërinë civile në Kosovë duke ofruar grante në tri fushat tematike të lartpërmendura si për organizata, ashtu edhe për individë.

Në këtë drejtim, një nga **arritjet kryesore** në vitin e kaluar ishte përpjekja e Fondacionit për ta krijuar **Green Action Space** - një platformë fizike dhe virtuale për të hulumtuar dhe diskutuar çështje të ngutshme klimatike dhe mjedisore. Në partneritet me Institutin Riinvest, Fondacioni e themeloi GAS-in në fund të vitit 2021 dhe e lansoi atë bashkë me komponentin e tij arsimor dhe të ngritjes së kapaciteteve, **Shkolla e Gjellbër**. Si rezultat i angazhimit të drejtpërdrejtë të menaxhmentit dhe stafit të Fondacionit, Shkolla e Gjellbër u krijua si një platformë udhëheqëse për edukimin e aktivistëve, politikëbërësve dhe gazetarëve mbi çështjet aktuale të ndryshimeve klimatike. Grupi i parë i Shkollës së Gjellbër diplomoi në vitin 2022. Shkolla do ta vazhdojë punën e saj me grupin e dytë gjatë gjithë vitit 2023.

Përveç avokimit të Fondacionit në drejtim të zbatimit të Agjendës së Gjellbër, një tjetër arritje e shënuar ishin përpjekjet e vazhdueshme të Fondacionit në kuadër të Programit të tij për Rilidhjen e Komuniteteve me **Nismën e Hapur**, një koalicion i organizatave serbe të Kosovës. Gjatë gjithë vitit, koalicioni i dhjetë organizatave dha kontributin e tyre shumë të nevojshëm në çështjet kyçe që ndikojnë në jetën e komunitetit serb në Kosovë duke prodhuar analiza, duke organizuar debate dhe duke avokuar për ndryshimin e politikave në nivelin lokal dhe qendror.

Në vitin 2022, Fondacioni gjithashtu e vazhdoi punën me projektin e tij kryesor, **Bursa Kosovare për Hulumtim dhe Analizë**, i cili u ofron ekspertëve të rinj të politikave dhe akademikëve mentorim dhe mbështetje financiare për të prodhuar hulumtime mbi politikën. Ndërsa grupi i pestë shënoi botimin e rezultatit të tij përfundimtar, një vëllim akademik, i redaktuar nga ekspertët kryesorë për Evropën Juglindore, "Ballafaqimi me Kriza të Shumëfishta: Perspektivat Lokale dhe Ndërkombëtare për Politikëbërjen në Kosovë", punën e filloi grupi i gjashtë i bursës, që do të vazhdojë gjatë gjithë vitit të ardhshëm.

Së fundi, gjatë vitit të kaluar, Fondacioni i Kosovës gjithashtu iu nënshtrua një transformimi të brendshëm si pjesë e riorganizimit global të Fondacionit për Shoqëri të Hapur për t'i përmbushur kërkesat dhe sfidat e reja. Procesi i transformimit e zhvendosi fokusin e Fondacionit në çështjet e brendshme dhe ristrukturimin, duke prekur pa dashje ndikimin e jashtëm të Fondacionit. Një ndryshim i dukshëm nga viti i kaluar ishte shkurtimi i fondeve bazë, i cili e kufizoi shtrirjen e veprimtarisë së Fondacionit gjatë tërë vitit 2022. Së fundi, në koordinim me strukturat globale të Shoqërisë së Hapur dhe si rezultat i një procesi të gjatë të brendshëm, duke filluar që nga viti 2023, Fondacioni do ta zhvendosë fokusin e tij në ndërhyrjet e integruara rajonale - një qasje e re ndaj punës që ka bërë që nga themelimi i tij si Fondacion kombëtar në vitin 1999. Ndërsa pjesa më e madhe e punës së Fondacionit do të realizohet në koordinim me fondacione të tjera kombëtare në Ballkanin Perëndimor, Fondacioni do të vazhdojë t'i mbështesë nismat lokale në nivel kombëtar nëpërmjet dhënies së granteve dhe nismave avokuese.

2. RAPORTI FINANCIAR

Fondacioni Kosoves per Shoqëri të hapur pasqyrat financiare për periudhën 1 janar
2022- 31 dhjetor 2022

Nr.	Linja Buxhetore	Buxheti €	Shpenzimet €	%
1	Kontributi thelbësor i OSF, Rrjeti dhe VSP			
	Programi ndërtematik	683 823,81	683 823,81	100,00
	Grantet Tie-off	647 862,06	647 862,06	100,00
	Programi i Ndarjes Vullnetare (VSP)	352 600,14	352 600,14	100,00
	Shpenzime administrative	288 315,67	288 315,67	100,00
	Nëntotali 1 :	1,972 601,68	1,972 601,68	
2	Fondet e Palëve të Treta			
	- Karl Kubel Stiftung - Prospect 3	97,999,91	97 999,91	100,00
	EU- Balkan Tender Watch	25 057,85	25 057,85	100,00
	OSFA - PV Panelet në shkollat në Ballkanin Perëndimor	58 402,00	58 402,00	100,00
	Nëntotali 2 :	181 459,76	181 459,76	
	Totali	2 154 061 €	2 154 061 €	

Shpenzimet e bëra sipas programeve-në euro




Fig.1. Shpenzimet e bëra sipas ndarjeve programore




Fig 2. Shpenzimet e bëra sipas programit, burimeve të financimit dhe kostove të transformimit




Fig.3. Shpenzimet e bëra sipas burimeve të financimit

Raporti i detajuar financiar për vitin 2022

Titulli i Projektit	Grantmarrësit	Shuma në Euro
Korridori i Gjellbër	Manifesta Pristina 14	10,000.00
Shkolla e Gjellbër II	Instituti Riinvest	44,720.10
Punëtorja e Kosovo Research and Analysis Fellowship në Prishtinë (Mars 2022)	Operacional	7,822.35
Shkolla e Gazetarisë Hulumtuese 2022	ÇOHU	10,000.00
Punëtori ÇOHU dhe KRIK "Shkolla e Gazetarisë Hulumtuese - Dëmtimi i mjedisit" 27-31.05.2022	Operacional	13,744.09
Punëtori me Sekretariatit CiviKos, Zyra për Qeverisje të Mirë të Kryeministrit në Këshillin e Bashkëpunimit bw Qeverisë dhe OSHC-ve, 1-3.06.2022	Operacional	3,689.00
Serbia tjetër 3	Admovere	9,970.00
Botim i librit "Galeria Dodona Prishtine 1997-1999"	Alisa Maliqi	3,070.18
Punëtorja fillestare e KRAF-it dhe konferenca rajonale 23-26.11.2022	Operacional	10,871.63
Konsulencë KRAF		12,000.00
Mbikëqyrja KRAF		6,227.05
Mbikëqyrja KRAF		7,835.24
Mbikëqyrja KRAF		6,000.00
Bursa KRAF		4,210.00
Bursa KRAF		3,684.21
Bursa KRAF		4,100.00
Bursa KRAF		4,426.97
Bursa KRAF		4,448.76
Bursa KRAF		3,684.21
Bursa KRAF		4,288.54
Bursa KRAF		4,400.00
Dialog Diplomatik	Forumi për Marrëdhëniet Etnike (FER)	4,920.00
Forumi i Politikës së Jashtme të Tiranës - Bashkëpunimi Rajonal	AIIS - Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare	2,900.00
CEC Mitrovica	NGO "Aktiv"	10,605.18
CEC Gracanica	FDMC - Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik	9,500.00
Punëtorja Sporazoom 7-8 Prill 2022	Sporazoom - Operacional	2,674.51
Punëtorja Nisma e Hapur 8-10 Prill 2022	Open - Operacional	3,094.96
Grupi i Planifikimit Strategjik	Grupi i Planifikimit Strategjik	2,073.67
CEC Gracanica	FDMC - Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik	7,260.00
CEC Mitrovica	NGO "Aktiv"	9,310.00
Forcimi i Dialogut Social në Kosovë	NGO CASA - Qendra për Veprime Afirmative Sociale	42,180.00
Çështjet kryesore - Formatet e videove	KIM Radio	4,700.00
Nëntotali:		278,410.65

Raporti Vjetor 2022:

Një vit i transformimeve të mëdha

Shpenzimet e transformimit		
Tie off – Grant i Transformimit	Instituti Riinvest	457,200.00
Tie off – Grant i Transformimit	KEC- Qendra për Arsim e Kosovës	188,800.00
VSP- Programi i Ndarjes Vullnetare (Buxheti i Rrjetit dhe Bazë)	KFOS -Stafi	437,933.93
		Nëntotali 1,083,933.93
Shpenzimet e programit Konferenca, takime dhe seminare		
Karl Kubel Stiftung Puntëtorja e datave 25-28.04.2022	Operacional	8,568.32
Punëtorja e Shkollës së Gjellbër e datave 20-22.05.2022	Operacional	2,846.87
Gjërëqina Tuhina & Augustin Palokaj Takimi i BE-së	Operacional	1,735.35
AiIS Takimet Prill-Dhjetor në Tiranë	Operacional	4,608.29
Programi Retreat Selanik 01-03.04.2022	Operacional	5,641.95
Karl Kubel Stiftung punëtorja e datave 03-05.11.2022	Operacional	7,920.02
Konferenca e Sao Paolos për energjinë e qëndrueshme	Operacional	7,659.29
Konferenca e Beogradit e datave 30.11-02.12.2022	Operacional	2,487.53
Takimi i Gjenezës dhe Brukselit	Operacional	9,734.96
Takimi i Berlinit i datave 15-18.12.2022	Operacional	7,144.83
Ngjarja në Klan Arena e KFOS-it	Operacional	2,973.30
Open/Sporazoom Takimi i datave 18-21.08.2022	Operacional	8,792.71
Retreat i Ballkanit Perëndimor	Operacional	1,231.22
Shpenzime të tjera për takime, seminare etj.	Operacional	4,232.51
		Nëntotali 75,577.15
Shpenzime të tjera profesionale	Operacional	28,791.95
Publikime	Operacional	27,776.06
Asetet fikse	Operacional	3,817.50
Programi Tjetër – Shpenzime Administrative lidhur me projektet	Operacional	20,726.93
Shpenzimet e stafit të programit	Operacional	165,251.84
		Nëntotali 246,364.28

Shpenzimet totale të programit**1,684,286.01**

3. PROCESI I TRANSFORMIMIT

Në vitin 2021, Fondacionet për Shoqëri të Hapur filluan punën për transformimin e rrjetit global të fondacioneve të krijuara nga filantropi miliarder George Soros. Në bashkëpunim të ngushtë me Bordin Global të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, udhëheqja e organizatës e filloi detyrën e mundimshme të riorganizimit dhe përshtatjes së një strukture globale të programeve tematike dhe rajonale, si dhe një sërë fondacionesh dhe zyra të pavarura, për t'i bërë ato të përshtatshme për t'iu përgjigjur një peizazhi politik që ndryshon me shpejtësi. Me misionin për ta bërë organizatën më të zhdërvjellët dhe më të shkathët, procesi i transformimit çoi në ristrukturimin e Fondacioneve për Shoqëri të Hapur në mbarë botën, si dhe në largimin e shumë kolegëve. Në vitin 2022, procesi i transformimit u shtri edhe në entitetet e Ballkanit Perëndimor, ku u trajtua çështja e së ardhmes së fondacioneve kombëtare.

Në Kosovë, Fondacionet për Shoqëri të Hapur fillimisht kishin filluar punën e tyre përmes një zyre degë të Fondacionit Soros për Jugosllavi, e themeluar fillimisht në Beograd në vitin 1991. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, kjo zyrë u shndërrua në një fondacion të pavarur kombëtar, i themeluar zyrtarisht në fund të vitit 1999. Në tri dekadat e fundit, Fondacioni për Shoqëri të Hapur ka qenë i pranishëm si donator në Kosovë e rajon, kryesisht përmes pesë fondacioneve të pavarura kombëtare, si dhe përmes mbështetjes së ofruar drejtpërdrejt nga programet tematike dhe rajonale me seli në Budapest, e më vonë në Berlin.

Si fondacione të pavarura, organizatat në rajon bashkëpunuan në nisma dhe projekte të përbashkëta dhe, në raste të rralla, punonin drejtpërdrejt me partnerë në vende të tjera të rajonit. Udhëheqja e fondacioneve rajonale u takua rregullisht për qëllime koordinimi dhe derisa nuk shpërtheu pandemia Covid-19, i gjithë stafi i pesë fondacioneve, si dhe kolegët nga programet e tjera të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, takoheshin çdo vit në Forumin e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, secili fondacion i raportoi Bordit të vet Ekzekutiv dhe hartoi e zbatoi strategji të veçanta afatmesme me fokus dhe prioritetet specifike tematike. Fondacionet kombëtare në rajon ndryshonin edhe për sa i përket funksionimit

të tyre, duke ndryshuar në madhësi dhe fushë të punës dhe në menaxhim të financimit nga palët e treta.

Si pjesë e procesit të transformimit, drejtorët ekzekutivë të çdo fondacioni kombëtar u konsultuan në faza të ndryshme të procesit të vendimmarrjes për transformimin e mundshëm, përkundër faktit që vendimi përfundimtar i takonte udhëheqjes së lartë të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur. Modele të shumta për riorganizimin e Fondacioneve u diskutuan gjatë fundit të vitit 2021 dhe në fillim të vitit 2022, por nuk u mor asnjë vendim përfundimtar. Në maj u prezantua një plan transformimi, i cili u bën thirrje të gjitha fondacioneve kombëtare të vazhdojnë me hapjen e Programit të Ndarjes Vullnetare (PNV), i cili do t'i mundësonte stafit që do të dëshironte të largohej vullnetarisht nga Fondacionet, të largohej me një kompensim bujar financiar për kontributin e tyre. PNV-ja në Fondacionin e Kosovës u hap në qershor 2022, dhe, si rrjedhojë, gjashtë anëtarë të stafit u larguan.

Si rezultat i diskutimeve të vazhdueshme rreth fokusit të ardhshëm programor të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur, Fondacioni i Kosovës gjithashtu vendosi të mbyllë programe specifike dhe të largohet nga ato me përgjegjësi duke u ofruar organizatave partnere grante tie-off. Një shpjegim më i detajuar i granteve tie-off, të ofruara nga KFOS-i, është dhënë në nënseksionin në vijim.

Diskutimet për të ardhmen e fondacioneve në rajon vazhduan deri në vjeshtën e vitit 2022. Duke gjetur hapësirë për përmirësimin e mënyrës se si fondacionet kombëtare kishin funksionuar në të kaluarën, udhëheqja e lartë e Fondacioneve për Shoqëri të Hapur zbuloi se ndikimi i zyra në rajon mund të rritet përmes një rishikimi strategjik dhe operacional. Në janar 2023, udhëheqja e lartë njoftoi se fondacionet kombëtare do të vazhdojnë të ekzistojnë si subjekte të pavarura juridike në çdo vend, por do të bashkohen për ta hartuar një strategji të vetme për rajonin dhe do të funksionojnë në një mënyrë të koordinuar në baza rajonale nën udhëheqjen e Drejtorit Rajonal.

3.1 GRANTET TIE-OFF

Si pjesë e procesit të transformimit dhe riorganizimit, Fondacionet për Shoqëri të Hapur në tërë botën duhej të vlerësonin me ndershmëri dhe pragmatizëm se ku puna e tyre pati ndikimin më të madh. Një proces i tillë çoi në mënyrë të pashmangshme në përfundimin se Fondacionet mund të përfitonin nga kufizimi i fushës së tyre të punës dhe nga kanalizimi i mbështetjes së tyre në fushat ku fondacionet mund të luanin rol në bërjen e ndryshimeve vendimtare. Për të dalë nga fusha të caktuara të punës me përgjegjësi ndaj palëve të interesit, partnerëve dhe marrësve të granteve, si dhe për ta ruajtur trashëgiminë e punës së bërë nga Fondacionet, ekipi për transformim e paraqiti mundësinë e ofrimit të mbështetjes për krijimin e programeve dhe projekteve, dhe sigurimin e mbështetjes financiare me grante për partnerë për ta vazhduar punën (përmes granteve tie-off). Në Kosovë, Fondacioni vendosi që dy fusha kryesore të punës mund të transferohen tek organizatat kryesore partnere përmes granteve tie-off.

Brenda vendit, ndryshimi i madh programor ishte dalja e Fondacionit nga puna e tij në arsimin e lartë dhe nga programi kundër korrupsionit dhe transparencës. Këto dy programe, të cilat kanë qenë fusha kryesore e punës për këtë fondacion gjatë dekadës së kaluar, e kanë mbështetur angazhimin e OSHC-ve në Kosovë në kërkimin e llogaridhënies dhe integritetit në sektorin publik. Si pjesë e punës së Fondacionit në këto dy fusha, KFOS-i gjithashtu i ka krijuar dy koalicione me OSHC të tjera nga Kosova: a. Koalicioni ProOpen për të Dhëna të Hapura dhe Përgjegjësi në Prokurimin Publik, dhe b. Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU). Për ta ruajtur trashëgiminë e punës së këtyre dy koalicioneve, si dhe punët e tjera programore të zbatuara drejtpërdrejt nga Fondacioni në të kaluarën, Fondacioni u siguroi dy organizatave partnere grante tie-off, Institutit Riinvest dhe Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC).


KFOS-i dhe Instituti Riinvest kanë një histori të gjatë të bashkëpunimit. Si një nga OSHC-të më të vjetra në vend, Instituti Riinvest ka qenë partneri kryesor për KFOS-in në shumë projekte dhe programe operative. Në vitin 2003, këto dy organizata e krijuan platformën e avokimit Forum2015, e cila shpejt u bë hapësirë e respektuar për t'i paraqitur analizat e politikave dhe për ta nxitur debatin ndërmjet palëve vendore dhe ndërkombëtare të interesit. Një fushë tjetër kryesore e bashkëpunimit ndërmjet KFOS-it dhe Riinvestit ishte

prokurimi publik dhe anti-korrupsioni. Ky bashkëpunim rezultoi në disa projekte dhe punime hulumtuese që i trajtonin projektet e mëdha infrastrukturore, si ndërtimi i një termocentrali të ri me thëngjill dhe dhënia me koncesion e aeroportit të Prishtinës.

Për t'i vazhduar aspektet e shumta të punës në të cilat KFOS-i ishte i përfshirë, Riinvesti mori një grant tie-off për 18 muajt e ardhshëm për ta mbështetur punën e tyre në (1) projektet kundër korrupsionit, veçanërisht në rastet e investimeve të mëdha strategjike që janë bërë burim i përhershëm i skandaleve korruptive; (2) në rritjen e transparencës në institucionet qeveritare dhe administratën publike, si vazhdimësi e përpjekjeve të përbashkëta nga tri vitet e fundit në Open Data dhe Open Government Partnership (ku Kosova ende nuk është anëtare); dhe (3) në organizimin e Forum2015, si bashkëthemelues i platformës gati dy dekada më parë.

Granti tjetër 18-mujor i është dhënë Qendrës së Arsimit të Kosovës (KEC), e cila është themeluar në vitin 2001 pas ndërprerjes së programit të Fondacionit për arsim, për ta mundësuar rritjen e shtrirjes dhe ndikimit të tij. KEC-i shpejt arriti të bëhet dhe të mbetet përkrahësi më i madh i zhvillimit të arsimit në vend. Përmes KEC-it, FSHH-ja mbështeti programe, si hap pas hapi, leximi dhe të menduarit kritik, administrimi i shkollës dhe arsimit i lartë, që u bënë platformat më të organizuara të një sistemi bashkëkohor arsimor në Kosovën e pasluftës. Në këtë kuptim, KFOS-i dhe KEC-i janë shumë të ndërlidhur dhe kanë bërë punë të madhe të përbashkët në fushën e arsimit në dy dekadat e fundit.

Gjatë 18 muajve të ardhshëm, KEC-i do ta marrë përsipër punën në këto fusha: (1) Projekte hulumtuese, monitoruese dhe avokuese lidhur me qëllimet dhe objektivat e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), në bashkëpunim të ngushtë me universitetet publike, Ministrinë e Arsimit dhe palët e tjera përkatëse të interesit; (2) Punë të vazhdueshme në projektin QAINTE duke e monitoruar performancën akademike të universiteteve publike e private, dhe mbështetje për organizimin e studentëve brenda këtyre institucioneve; (3) Administrimin e KITU-së dhe fuqizimin e performancës së anëtarëve të tij; sigurimin e qëndrueshmërisë nga donatorët e tjerë në zonë dhe zgjerimin e aktiviteteve në nivel rajonal.



Si pjesë e procesit të transformimit dhe riorganizimit, Fondacionet për Shoqëri të Hapur në tërë botën duhej të vlerësonin me ndershmëri dhe pragmatizëm se ku puna e tyre pati ndikimin më të madh. Një proces i tillë çoi në mënyrë të pashmangshme në përfundimin se Fondacionet mund të përfitonin nga kufizimi i fushës së tyre të punës dhe nga kanalizimi i mbështetjes së tyre në fushat ku fondacionet mund të luanin rol në bërjen e ndryshimeve vendimtare.



4. ANKORIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË STANDARDET E BE-SË DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

Gjatë vitit të kaluar, përveç proceseve të tij të brendshme, Fondacioni vazhdoi të angazhohej në mënyrë aktive në dhënien e granteve dhe në projekte operative në kuadër të programit për integrim dhe bashkëpunim rajonal në BE. Duke u përqendruar në vazhdimin e projekteve të trashëguara, si Bursa Kosovare për Hululumtim dhe Analizë (KRAF), dhe në organizimin e debateve për politika, Fondacioni arriti t'i organizojë **dy seminare kryesore rajonale** në Prishtinë, disa takime të mbyllura me zyrtarë, dy promovime publike të rezultateve të bursës së KRAF-it (libër dhe punime) dhe një sërë tryezash të rrumbullakëta për çështje të ndryshme si liberalizimi i vizave dhe bashkëpunimi rajonal. Përveç përpjekjeve të tij operative të zbatuara në koordinim me partnerët, Fondacioni gjithashtu i mbështeti organizatat dhe individët me seli në Kosovë me grante të vogla që theksonin marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Serbinë, ose përmbanin një komponent rajonal të bashkëpunimit (si shkolla e gazetarisë hulumtuese e organizuar nga Çohu dhe KRIK), dhe projekte hulumtuese që përqendrohen në trashëgiminë e viteve 1990. Më poshtë janë disa nga arritjet kryesore të këtij programi gjatë vitit 2022.

4.1 BURSA E KOSOVËS PËR HULUMTIM DHE ANALIZË (KRAF)

Për të gjashtin vit me radhë, Fondacioni vazhdoi me zbatimin e projektit të tij kryesor operativ Bursa e Kosovës për Hululumtim dhe Analizë (KRAF). Kjo bursë, e cila u krijua për t'i mbështetur hulumtuesit e rinj nga vendet e rajonit, si dhe nga vendet anëtare të BE-së që

nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, vazhdoi t'i sfidojë përfaqësimet stereotipike të Kosovës dhe ta zgjerojë prodhimin e njohurive për vendin. Në vitin 2022, Fondacioni e përfundoi punën me grupin e pestë të bursës, vazhdoi mbështetjen e tij për angazhimin e alumneve, dhe përzgjodhi dhe nisi punën me grupin e gjashtë.

Në mars, 12 bursistët e përzgjedhur të grupit të pestë, të sfondeve të ndryshme akademike, kryen hulumtimin e tyre në terren në Kosovë, duke e filluar vizitën e tyre me një punëtori intensiv në Prishtinë. Grupi i pestë përbëhej nga bursistët nga e tërë Evropa, përfshirë hulumtues nga Spanja, Rumania dhe Polonia. Gjatë gjithë vitit, grupi prodhoi dhjetëra artikuj opinionesh, të prezantuara para qarqeve akademike e politike dhe në fund botoi një vëllim të redaktuar me hulumtime origjinale të titulluar "Ballafaqimi me kriza të shumëfishta: Perspektiva lokale dhe ndërkombëtare për politikëbërjen në Kosovë". Ngjarja përfundimtare për këtë cikël të projektit u mbajt më 24 nëntor; vëllimi i redaktuar u promovua në Qendrën për Praktikë Narrative (CNP) në Prishtinë me një panel të përbërë nga tre nga bursistët, Marta Szpala, Hana Bacaj dhe Ana Krstinovska, një nga mbikëqyrësit, Gëzim Krasniqi. Ngjarjen e moderoi mbikëqyrësi akademik i bursës, Dr. Ioannis Armakolas. Aktiviteti u ndoq nga dhjetëra ekspertë dhe u mbulua edhe nga mediat lokale. Vëllimi i promovuar, i redaktuar nga koordinatori akademik i bursës dhe mbikëqyrës të shumtë, paraqet intervenimet në kohë dhe origjinale që i përgjigjen kohës së krizave politike—një periudhë e shënuar nga pandemia Covid-19, pushtimi i Ukrainës dhe krizat e sigurisë dhe energjisë. Libri me qasje të hapur është shpërndarë deri më tani nëpër libraritë dhe bibliotekat

lokale në Kosovë dhe është në dispozicion online në ueb sajtin e KFOS-it.

Përveç punës së prodhuar nga grupi i pestë i KRAF-it, alumnit e bursës vazhduan të punojnë në dokumente të politikave dhe në avokim. Gjatë gjithë vitit 2022, Fondacioni publikoi katër përmbledhje të politikave të prodhuara nga ekipe të alumnive të përbëra nga dy bursistë si publikime të pavarura që trajtonin çështje përkatëse prej liberalizimit të vizave deri te diplomacia sportive. Një nga përmbledhjet e politikave, e prodhuar nga José Carpintero Molina dhe Juan Manuel Montoro, me titull “Kosova dhe bota spanjishtfolëse: Hulumtimi i rrugëve drejt angazhimit kur njohja bllokohet”, u prezantua në një takim të mbyllur me Ministrin e Jashtëm të Kosovës dhe u shpërnda gjerësisht në qarqet e politikës së jashtme. Më 24 nëntor, Fondacioni organizoi një diskutim publik mbi një dokument tjetër të politikave të shkruar nga dy alumni, Dr. George Kyris dhe Juan Manuel Montoro, të titulluar “Diplomacia sportive e Kosovës: Duke iu qasur ndërkombëtares, duke e ndërtuar kombëtaren”. Përveç një paneli të ekspertëve të sportit nga rajoni, ngjarja bashkoi përfaqësues të sportit, sportistë dhe zyrtarë qeveritarë për të diskutuar se si sporti mund të ndihmojë në vendosjen e Kosovës në hartë.

Njëkohësisht, Fondacioni punoi ngushtë me mbikëqyrësin akademik në strukturimin e grupit të gjashtë të bursës. Në tetor, Fondacioni hapi një thirrje për aplikim për grupin e ri të bursës KRAF me një fushë të kufizuar të temave dhe duke u kërkuar aplikantëve të prodhojnë përmbledhje të politikave, në vend të një vëllimi të redaktuar. Prej pothuaj njëqind aplikacioneve, komisioni përzgjedhës zgjodhi 8 bursistë të rinj për të bërë hulumtime dhe për të shkruar përmbledhje të politikave në tema që sillen nga punët e jashtme deri te bashkëpunimi rajonal, varfëria dhe siguria energjetike. Të gjithë bursistët u ftuan në një punëtori fillestare në Prishtinë, në fund të nëntorit, ku patën mundësi të takohen me mbikëqyrësit e tyre, koordinatorët e projektit, si dhe të marrin pjesë në ligjërata publike dhe të mbyllura për temat e tyre të hulumtimit. Puna e këtij grupi pritet të përfundojë në mesin e vitit 2023.

4.2 LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN: FUNDLOJA

Ka mbi 10 vjet që Institucionet e Kosovës e kanë filluar dialogun për liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian. Përderisa qytetarët e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor kanë gëzuar udhëtim pa viza në zonën Shengen që nga viti 2009, përkatësisht 2010, kosovarët vazhdojnë të jenë të vetmit qytetarë në perëndim të Bjellorusisë që duhet të aplikojnë për viza për të udhëtuar për t'i vizituar familjet ose miqtë e tyre në Evropë.

Fondacioni ka qenë shumë i përfshirë në avokimin për një regjim pa viza për qytetarët kosovarë që nga fillimi, por ai e rriti angazhimin e tij veçanërisht në vitin 2015 kur mbledhi 25.000 nënshkrime për një peticion drejt BE-së për ta bërë regjimin pa viza realitet. Në vitin 2022, me Presidencën Çeke që synonte ta fuste këtë çështje në rend dite, shpejt u bë e qartë se përderisa kishte një mundësi që Këshilli Evropian ta jepte më në fund dritën e gjelbër për liberalizimin e vizave për Kosovën, kishte edhe mundësi që disa shtete anëtare të vënë kushte të reja dhe ta vonojnë edhe më shumë procesin.

Në një përpjekje për t'i adresuar këto kurthe potenciale, në shkurt 2022, Fondacioni publikoi një përmbledhje të politikave të prodhuar nga dy prej alumnive të KRAF-it, **Zoran Nechev dhe Donika Emini “Liberalizimi i vizave: Saga e Kosovës në rrugën drejt BE-së”**. Ky dokument u shpërnda në qarqet politike dhe ndihmoi të shprehej ndjenja e zhgënjimit që kosovarët kishin ndaj premtimit të thyer të BE-së, edhe pse nuk pati publikim apo diskutim të dokumentit.

Në korrik, marrësi i grantit të KFOS-it, **Instituti i Politikave Evropiane i Kosovës (EPIK)**, bashkë me **Institutin Clingendael**, organizoi një panel diskutimi **“Rrugë e Kosovës drejt BE-së: Çfarë progresi në liberalizimin e vizave dhe në dialogun Beograd-Prishtinë”** në Hagë. Diskutimi mbledhi politikëbërës të nivelit të lartë nga Holanda, si dhe i bashkoi zërat nga sektori i shoqërisë civile të Kosovës në qendrën e politikës holandeze. Bashkëpunimi, i cili u mbështet nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Berlin dhe KFOS-i, prodhoi një dokument të përbashkët që i trajtonte dyshimet e mbetura të zyrtarëve holandezë që kishin qenë kundër liberalizimit të vizave në të kaluarën.

Pasi Presidenca Çeke e vendosi këtë çështje në rendin e ditës për tetorin e vitit 2022, Fondacioni e ktheu vëmendjen e vet në pengesat e tjera të mundshme me të cilat Kosova do të mund të ballafaqohej nga shtetet anëtare që ishin skeptike për përparimin e Kosovës në sundimin e ligjit. Me thashethemet që qarkullonin se Spanja, Suedia dhe Franca do të vendosnin kushte të reja para se ta ofronin liberalizimin e vizave, Fondacioni organizoi një panel diskutimi në Prishtinë, më 14 nëntor, me titull **“Liberalizimi i vizave për Kosovën: Fillimi i fundit?”**, gjatë të cilit dy analistët me seli në Bruksel, Gjeraqina Tuhina dhe Augustin Palokaj, e prezantuan përmbledhjen e tyre mbi politikën “Finalja e Madhe”. Ngjarja u përcoll nga dhjetëra ekspertë dhe u mbulua nga shumica e mediave kombëtare në Kosovë.

Në fund të nëntorit, ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së u pajtuan që Kosovës t’i jepet një regjim pa viza me futjen e sistemit të ri të regjistrimit elektronik ETIAS, dhe jo më vonë se 1 janari 2024.

4.3 BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE DIALOGU KOSOVË-SERBI

Gjatë tërë vitit 2022, Fondacioni ka qenë aktivisht i përfshirë në mbështetjen e projekteve që janë në përputhje me aspiratat e Kosovës për integrim në BE – parakushte për të cilin janë normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, si dhe bashkëpunimi më i mirë rajonal në përgjithësi. Duke mos u përqendruar drejtpërdrejt në vetë procesin e dialogut, Fondacioni i mbështeti marrësit e granteve për ta lehtësuar një dialog për rrugën përpara dhe për të ofruar alternativa për krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore.

Një nismë e tillë ishte projekti i Admovere-s **“Serbia tjetër”**, një seri e publikimeve të shkrimeve nga intelektualë publikë serbë që e kishin kundërshtuar regjimin e Millosheviqit gjatë viteve 1990. Në vitin 2022, organizata e publikoi pjesën e tretë të saj **“Serbia tjetër: Srdja Popovic”**, që është botuar në tri gjuhë, është shpërndarë në Prishtinë dhe është promovuar online përmes platformës S’bunker. Libri do të promovohet në Beograd në vitin 2023 gjatë “Festivalit Mirëdita Dobardan”.

Ndërsa gjatë gjithë vitit marrëdhëniet Kosovë-Serbi u shënuan me tensione dhe mosmarrëveshje për targat e veturave dhe me barrkada dhe rezultuan në largimin masiv të serbëve të Kosovës nga postet dhe institucionet publike, ky vit shënoi një kthesë pozitive për bashkëpunimin rajonal. Ndërsa një samit trepalësh i nismës për Ballkanin e Hapur, i shoqëruar nga Open Balkan Wine Vision, një panair rajonal i verës, u mbajt në Beograd në shtator, zhvillimi kryesor i vitit ishte rigjallërimi i Procesit të Berlinit nën patronazhin e kancelarit Scholz. Më 3 nëntor, në Berlin, të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nënshkruan dy marrëveshje të reja që lejojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve me letërnjoftim dhe njohjen e diplomave dhe certifikatave profesionale.

Në mbështetje të nismave të tilla të bashkëpunimit të mirë dhe për ta promovuar një vizion përpara, Fondacioni mbështeti një sërë debatesh të nivelit të lartë në Beograd, Tiranë dhe Berlin gjatë dhjetorit. Në Beograd, Fondacioni e mbështeti **Forumit për Marrëdhënie Etnike (FER)**, për ta organizuar **Dialogun Diplomatik “Bashkëpunimi rajonal si ‘projekt paqeje’”** më 1 dhjetor. Paneli përbëhej nga autori Veton Surroi, Dusan Janjic, President i FER-it, dhe Zoran Drakulic, President i Klubit Afarist Serb “Privrednik”. Paneli tërhoqi një audiencë të nivelit të lartë të trupit diplomatik dhe të ekspertëve politikë nga Serbia.

Në Tiranë, Fondacioni e mbështeti Institutin Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIS) për ta organizuar **Forumit e Politikës së Jashtme në Tiranë: Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian në kohë lufte**, më 9 dhjetor, ku Surroi ishte në një diskutim me Alba Çelën, drejtoreshë ekzekutive e AIIS-it. Së fundi, bashkë me Këshillin e Politikave të Demokratizimit (DPC), KFOS-i organizoi një tryezë të mbyllur në Berlin **“E ardhmja e bashkëpunimit rajonal pas Samitit të Berlinit: Drejt një strategjie gjithëpërfshirëse politike?”** në Paul-Lobe-Haus (pjesë e kompleksit të Bundestagut gjerman) më 16 dhjetor. Diskutimi tuboi dhjetëra pjesëmarrës, deputetë/anëtarë nga partitë e koalicionit qeverisës, një përfaqësues të MPJ-së gjermane, përfaqësues të fondacioneve partiake të partive të koalicionit qeverisës (FES, HBS, FNS), nga FShH Berlin dhe qendra të rëndësishme hulumtuese me seli në Berlin, aktive në Ballkanin Perëndimor (si Instituti Aspen në Gjermani).



5. PROGRAMI I GJELBËR

Gjatë vitit 2022, Programi i Gjellbër u përqendrua në tri objektiva kryesore. Së pari, Fondacioni dhe partneri i tij, Instituti Riinvest, i rifilluan Bisedimet e Gjellbra me qëllim që ta rrisin ndërgjegjësimin, të iniciojnë debate për çështjet që lidhen me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe të fillojnë të ushtrojnë presion në politikëbërës për ta çuar përpara këtë agjendë. Nga ana tjetër, bashkë me partnerin zbatues, Institutin Riinvest, Fondacioni e filloi gjeneratën e dytë të Shkollës së Gjellbër në dhjetor 2022, e cila synon t'i fuqizojë zyrtarët publikë, nëpunësit e shoqërisë civile, mediat dhe bizneset në çështjet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe përm-bushjen e angazhimeve të marra në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Punëtorja e parë u mbajt në Durrës, në dhjetor, e pasuar nga ligjërata e parë që u mbajt në Prishtinë. Shkolla pritet të përfundojë me grupin e dytë në maj 2023.

Përveç kësaj, si pjesë e fondeve të përbashkëta nga FShH, një studim u krye në vitin 2021 për ta eksploruar potencialin e përdorimit të teknologjisë diellore në shkallë të vogël, të montuar në çati, në disa shkolla fillore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Në Kosovë u përzgjedhën shkollat “Iliria” dhe “Qamil Batali”. Në fund të vitit, panelet diellore ishin në funksion dhe një pjesë e energjisë mbulohej nga vetëprodhimi. Projekti do të vazhdojë gjatë gjithë vitit 2023. Projekti synon t'i zgjerojë burimet e të ardhurave për shkolla publike, ta forcojë vetëqeverisjen dhe pronësinë e programeve sociale, ta mbështesë kalimin drejt energjisë së qëndrueshme, ta rrisë përfshirjen sociale në arsim dhe të krijojë shkolla miqësore për mjedisin.

5.1 KORRIDORI I GJELBËR – MANIFESTA 14

Në vitin 2022, Fondacioni e mbështeti bienalen no-made Manifesta 14 për ta krijuar Korridorin e Gjellbër. Studimi “Megjithatë publike”, i udhëhequr nga Carlo Ratti Associati, zbuloi se gjendja e keqe e hapësirave publike dhe dominimi i automjeteve në Prishtinë ndiko-

jnë negativisht në lëvizshmërinë e qytetarëve të cenusshëm. Nisma për Korridorin e Gjellbër, një bashkëpunim ndërmjet Manifesta 14, komunës së Prishtinës dhe UN Habitat-it, synonte përmirësimin e hapësirave publike duke e transformuar një pjesë të një shtegu hekurudhor në shteg për këmbësorë për t'i lidhur lagjet me qendrën e qytetit. Korridori i Gjellbër u hap më 22 korrik 2022 dhe pati ndikim pozitiv te banorët dhe vizitorët e Prishtinës duke ua ofruar një hapësirë të gjellbër dhe të qasshme për këmbësorë, duke rimarrë një zonë publike të pambikëqyruar, duke shërbyer si model për transformimin urban dhe duke promovuar ndërgjegjësimin dhe ndërtimin e komunitetit. Korridori i Gjellbër do të vazhdojë t'i lidhë zonat e qytetit dhe të ofrojë hapësirë të sigurt për komunitetin. Manifesta 14 dhe partnerët e saj planifikojnë ta aktivizojnë zonën përmes projekteve dhe ngjarjeve për komunitet.

5.2 BISEDIMET E GJELBRA

Projekti “Bisedimet e Gjellbra”, i iniciuar në nëntor 2021, përpiket t'i edukojë dhe informojë politikëbërësit publikë dhe palët përkatëse të interesit mbi implikimet dhe sfidat e paraqitura nga angazhimet e qeverisë së Kosovës në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Duke e përdorur platformën e Hapësirës për Veprim të Gjellbër, veçanërisht komponentët e saj të hulumtimit dhe avokimit, projekti do të përqendrohet në aspektet kryesore të planit të veprimit të Agjendës së Gjellbër.

Për këtë qëllim, projekti do të bashkojë ekspertë të fushës për të diskutuar për angazhimet dhe mundësitë e paraqitura nga pjesëmarrja e Kosovës në deklaratën e Agjendës së Gjellbër, si dhe sfidat e saj në krahasim me nënshkruesit e tjerë. Përveç kësaj, ekipi hulumtues i projektit do t'i publikojë gjashtë përmbledhje tematike të politikave, secila mbulon një nga pesë shtyllat e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, përfshirë dekarbonizimin, ekonominë qarkore, ndotjen, bujqësinë e qëndrueshme dhe mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetin.

Gjatë periudhës raportuese, katër nga gjashtë përmbledhjet tematike të politikave janë prezantuar dhe diskutuar, duke u thelluar në të ardhmen e thëngjillit në Kosovë, strategjinë energjetike të Republikës së Kosovës, përfitimet e mundshme të bashkëpunimit energjetik Kosovë-Shqipëri dhe të ardhmen e gazit në Kosovë. Dy temat e mbetura do të trajtohen gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

5.3 SHKOLLA E GJELBËR II

Pas përfundimit me sukses të grupit të parë të Shkollës së Gjelbër – që u mbajt nga nëntori 2021 deri në maj 2022, në të cilin 30 pjesëmarrës nga shoqëria civile, institucionet shtetërore dhe bizneset kanë përfunduar me sukses ciklin e ligjëratave, Fondacioni vendosi ta vazhdojë mbështetjen e tij për këtë nismë duke e financuar një grup të dytë të shkollës. Format i ciklit të dytë do të jetë i ngjashëm me formatin e ciklit të parë, dhe do të përfshijë ligjërata, punëtori tematike, diskutime dhe tryeza të rrumbullakëta. Përveç kësaj, shkolla synon ta inkurajojë debatin dhe partneritetin ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit për sfidat dhe implikimet që dalin nga angazhimet e Qeverisë së Kosovës për Agjendën e Gjelbër.

Për të pasur ndikim më të madh në ndërgjegjësimin dhe formimin e politikave publike dhe për të nxjerrë mësim nga cikli i parë, cikli i dytë i Shkollës së Gjelbër propozohet të organizohet në këtë format të kombinuar: 1. Cikli i dytë i shkollës, i titulluar “Shkolla e Gjelbër”, me pjesëmarrës të ndryshëm nga: (i) OJQ-të; (ii) mediat; (iii) bizneset; (iv) studentët pasuniversitar në fusha të ngjashme; dhe, 2. Cikli i fokusuar i trajnimeve, i titulluar “Trajnim me përfaqësues të institucioneve publike”, me pjesëmarrës nga: a. Departamentet e Ministrive; b. Përfaqësues nga agjencitë qeveritare (si p.sh.: Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës; Agjencia Kosovare e Minerave); c. Përfaqësues nga agjencitë e pavarura (si p.sh.: Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale; Zyra e Rregullatorit të Energjisë). Ligjëratat e grupit të dytë filluan në dhjetor 2022 me një seminar në Durrës, Shqipëri, dhe do të vazhdojnë të mbahen deri në prill 2023. Punëtorja fillestare dhe ligjërata e parë u mbajtën gjatë periudhës raportuese.

5.4 PANELET PV NË SHKOLLA NË BALLKANIN PERËNDIMOR - KOSOVË

Qëllimi i projektit është ta ulë varësinë e shkollave publike në financimin dhe mbështetjen nga qeveria qendrore. Në vitin 2021 u krye një studim për ta eksploruar potencialin e përdorimit të teknologjisë diellore në shkallë të vogël, të montuar në çati, në disa shkolla në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Projekti synon t'i zgjerojë burimet e të ardhurave për shkollat publike, ta forcojë vetëqeverisjen dhe pronësinë e programeve sociale, ta mbështesë kalimin drejt energjisë së qëndrueshme, ta rrisë përfshirjen sociale në arsim dhe të krijojë shkolla miqësore për mjedisin. Kjo do të arrihet përmes:

- ↘ Fuqizimit të komuniteteve: Duke u lejuar komuniteteve që ta gjenerojnë energjinë e tyre dhe ta zvogëlojnë varësinë e tyre nga ndërmarrjet e centralizuara, gjë që mund t'u japë atyre më shumë kontroll mbi furnizimin e tyre me energji dhe t'i bëjë ata më pak të prekshëm ndaj ndërprerjeve ose luhatjeve të çmimeve.
- ↘ Promovimit të pronësisë lokale: Inkurajimit të pronësisë së aseteve energjetike nga individë ose komunitete, në vend të korporatave të mëdha, të cilat mund të nxisin shpërndarje më të drejtë të përfitimeve ekonomike dhe të ndihmojnë në ndërtimin e ekonomive lokale më të forta dhe më elastike.
- ↘ Inkurajimit të pjesëmarrjes së qytetarëve: Duke nxitur pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në vendimmarrjen për energjinë, pasi individët dhe komunitetet bëhen më aktiv në planifikimin, financimin dhe funksionimin e projekteve energjetike.
- ↘ Reduktimit të emetimeve të karbonit: Duke ndihmuar në reduktimin e emetimeve të karbonit përmes rritjes së pjesës së energjisë së ripërtëritshme në përzierjen e përgjithshme të energjisë, duke kontribuar kështu në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

- Demokratizimit të tregjeve të energjisë: Duke krijuar mundësi të reja për prodhuesit e vegjël për të marrë pjesë në tregun e energjisë dhe për të konkurruar me shoqëritë e mëdha, duke i demokratizuar kështu tregjet e energjisë.

Gjatë periudhës raportuese, dy shkolla fillore në komunën e Prishtinës janë pajisur me panele diellore. Shkollat “Iliria” dhe “Qamil Batalli” kanë kapacitete të instaluar prej 18,90 kW, përkatësisht 20,25 kW. Prodhimi vjetor i shkollës “Iliria” është 21.608 kWh, ekuivalent me 2.499,31 euro, kurse prodhimi vjetor i shkollës “Qamil Batalli” është 24.937 kWh, ekuivalent me 2.199,50 euro. Këto shifra janë llogaritur duke e përdorur koston mesatare të energjisë elektrike në Kosovë.

Panelet diellore në shkollën “Iliria” u instaluan më 8 dhjetor 2022, kurse ato në shkollën “Qamil Batalli” më 29 dhjetor 2022. Tani të dyja shkollat prodhojnë energji për të plotësuar rreth 30% të kërkesës së tyre.

Zbatimi i këtij projekti e ka arritur me sukses objektivin e tij për uljen e varësisë së shkollave publike nga kontributet dhe subvencionet e qeverisë qendrore. Përveç kësaj, projekti do të ndihmojë në mbështetjen e tranzicionit ekologjik dhe në rritjen e përfshirjes sociale në arsim. Ndikimi financiar i projektit është i rëndësishëm, do të ketë ndikim pozitiv në buxhetin e shkollave, dhe pritet të ketë ndikim pozitiv afatgjatë në qëndrueshmërinë e shkollave.

Megjithatë, gjatë realizimit të projektit është zbuluar se prona në të cilën ndodhet shkolla “Iliria” nuk i është bartur zyrtarisht komunës në kadastër. Përkundër kësaj, ekipi i projektit ka qenë në kontakt me zyrtarë të komunës së Prishtinës për ta zgjidhur këtë çështje. Derisa prona t’i kalohet ligjërisht komunës, shkolla nuk do të mund të marrë leje nga KEDS-i për ta rikthyer në rrjet energjinë e tepërt të prodhuar nga panelet diellore. Kjo do të rezultojë në humbje financiare (ose përfitime të humbura) për shkollën, të vlerësuara në rreth 788 euro në vit.

5.5 RILIDHJA E MITROVICËS - QEQ MITROVICË DHE QEQ GRAÇANICË

Programi Rilidhja e Komuniteteve ka vazhduar edhe në vitin 2022 për ta mbështetur dialogun ndëretnik ndërmjet popullatës serbe dhe shqiptare. KFOS-i ka vazhduar t’i mbështesë të dyja Qendrat për Energji Qytetare (QEQ) në Mitrovicën e Veriut dhe në Graçanicë, të cilat e promovojnë dialogun dhe transparencën duke krijuar një kulturë të pjesëmarrjes demokratike. Të dyja qendrat, që menaxhohen nga OJQ-ja Aktiv dhe Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik, FDMC, i përdorin burimet e tyre për t’i mbështetur organizatat e tjera dhe grupet joformale duke organizuar ngjarje të ndryshme, me fokus në popullatën serbe në Kosovë. QEQ-at synojnë të organizojnë dialog të hapur të bazuar në komunitet dhe ta promovojnë lirinë e shprehjes për t’i kuptuar më mirë proceset kryesore shoqërore dhe politike në Kosovë. Ato gjithashtu synojnë t’i ndihmojnë organizatat e shoqërisë civile serbe të Kosovës dhe t’i forcojnë kapacitetet e tyre për t’u përfaqësuar dhe përfshirë në proceset vendim-marrëse në nivel lokal dhe qendror. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022, Qendra për Energji Qytetare në Mitrovicën e Veriut ka organizuar gjithsej 62 aktivitete me mbi 1.165 pjesëmarrës, kurse Qendra për Energji Qytetare në Graçanicë ka organizuar gjithsej 86 aktivitete me mbi 966 pjesëmarrës.

Aktivitetet e përshkruara në këto projekt-propozime u realizuan me sukses. Promovimi i dialogut ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve u zbatua në ngjarjet e mbajtura nga OJQ-ja Aktiv, Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik dhe organizata të tjera gjatë periudhës së projektit. Ngjarje të tilla, si fokus grupet, punëtoritë, konferencat dhe podkastet, e promovuan dialogun ndërmjet këtyre dy palëve dhe theksuan problemet e stereotipave të rrënjosur dhe dilemat që ato mund t’i krijojnë në procesin e bashkimit të komuniteteve që jetojnë në shoqëri të ndara, si dhe ballafaqimin me të kaluarën.

Mbështetja dhe organizimi i dialogut të hapur ndërmjet shoqërisë civile dhe vendimmarrësve u realizua përmes ngjarjeve të organizuara nga organizata të tjera dhe grupe formale e joformale të mbajtura në të dyja Qendrat për Energji Qytetare dhe përmes platformës Zoom. Këto aktivitete synonin forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, bashkëpunimin me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, aktorë joformalë, si dhe ofrimin e mbështetjes për grupet e cenueshme apo të marginalizuara shoqërore.

5.6 RITJIA E DIALOGUT SOCIAL NË KOSOVË

Në kuadër të përpjekjeve të programit Rilidhja e Komuniteteve, në fund të vitit 2022, Fondacioni e mbështeti OJQ-në Casa me një grant për ta mbështetur një dialog social ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë dhe aktorëve socialë nga komunitetet joshumicë, si dhe për të krijuar instrumente të reja të komunikimit social që do të kishin ndikim më të madh në publik dhe do të arrinin të një numër më i madh i njerëzve. Kjo nismë e merr si pikënisje gjendjen aktuale të marrëdhënieve etnike në Kosovë, e cila pothuajse dy dekada e gjysmë pas përfundimit të konfliktit, ende është një shoqëri thellësisht e ndarë, me tensione të vazhdueshme dhe ndarje sociale përgjatë vijave etnike. Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në forcimin e kohezionit social në shoqërinë kosovare përmes promovimit të kulturës së dialogut të hapur e të lirë si metodë themelore për zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet etnike. Kjo do të arrihet përmes: 1. Mbështetjes dhe fuqizimit të nismave ekzistuese të dialogut të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve relevante të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, dhe 2. Përmirësimit të dialogut të hapur publik për çështjet që i rëndojnë marrëdhëniet etnike në Kosovën e sotme.

Gjatë fazave fillestare të projektit, që filloi në dhjetor 2022, objektivi kryesor ishte vendosja e themeleve që nevojiten për zbatimin e tij të suksesshëm. Kjo përfshinte identifikimin e konsulencës së jashtme që ishte e nevojshme për të siguruar që rezultatet të jepeshin në mënyrë efikase dhe efektive. Një nga arritjet kryesore gjatë fazës fillestare ishte identifikimi i ekspertizës teknike dhe i pajisjeve të nevojshme për prodhimin e podkasteve. Ky është një aspekt kritik i projektit pasi siguron që podkastet janë të cilësisë së lartë dhe mund të arrijnë të një audiencë e gjerë.

Për sa i përket avokimit dhe dialogut, fokusi ishte në gjetjen e përpjekjeve ekzistuese për t'i promovuar interesat e komuniteteve lokale te vendimmarrësit në nivelin qendror. Përveç kësaj, u kërkuan mundësi për t'i zgjeruar këto përpjekje avokuese në shkallë ndërkombëtare. Ky është një komponent i rëndësishëm i projektit pasi siguron që zërat e komuniteteve lokale të dëgjohen dhe nevojat e tyre të adresohen në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në periudhën e ardhshme, organizata do ta zhvendosë fokusin e saj në zbatimin e aktiviteteve dhe ofrimin e rezultateve.

5.7 ÇËSHTJET KRYESORE - FORMATI I VIDEOS - KIM RADIO

Një projekt tjetër që ka të bëjë drejtpërdrejt me komunitetin serb të Kosovës është projekti i KIM Radios për shndërrimin e gjetjeve nga publikimi "Çështjet kryesore" në video klipe që përveçoheshin lehtë. Projekti do të përfundojë zyrtarisht në prill 2023, ka për qëllim ta stimulojë përfshirjen e qytetarëve në marrjen e njohurive më të mëdha për jetën dhe perspektivat në Kosovë përmes bashkëpunimit ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile dhe mediave. Qëllimi është rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe inicimi i një diskursi social për tema që janë thelbësore për rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes përfshirjes së tyre në krijimin e programeve televizive.

Qëllimi është që, gjatë rrjedhës së disa studimeve hulumtuese, të krijohen tri video klipe që hedhin dritë mbi sfidat me të cilat ballafaqohen serbët e Kosovës në realizimin e të drejtave të tyre themelore. Këto sfida përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, vështirësitë në funksionimin brenda kornizës së sistemeve të dyfishta administrative-shtetërore, veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe të arsimit, dominimin e një partie të vetme politike që i minon parimet demokratike dhe çështjen e përhapur të korrupsionit.

Partneri do të prodhojë dokumentarë të shkurtër mediatik, secili me kohëzgjatje deri në 15 minuta, në formën e përmbajtjes televizive të llojit hulumtues. Këto formate shërbejnë si platformë për qytetarët për t'i shprehur shqetësimet e tyre dhe për të kërkuar zgjidhje, me pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin aktiv të mediave dhe të organizatave të shoqërisë civile. Përmbajtja e videove do të publikohet në ueb sajtin e tyre, www.radiokim.net, në formatin video dhe në formatin në tekst, duke siguruar që të jetë e qasshme për audiencën lokale dhe globale. Përmbajtja do të ndahet edhe në platformat e mediave sociale, me mundësinë e diskutimeve dhe debateve të mëtejme për këto tema kritike dhe mundësinë që të dëgjohet një gamë e madhe e pikëpamjeve. Aktualisht, KIM Radio është në fazën e regjistrimit, sipas planit.

6. NISMA TË FINANCUARA NGA PALËT E TRETA

6.1 (RI)INTEGRIMI I ROMËVE, ASHKALINJVE DHE EGJIPTIANËVE TË RIATDHESUAR DHE TË CENUESHËM NË PEJË DHE SUHAREKË (PROSPEKTI 3)

Projekti Prospekti 3 ka vazhduar në dy komuna të Kosovës, Pejë dhe Suharekë, gjatë periudhës raportuese, me qëllim të mbështetjes së strategjisë së vendit për integrimin e komuniteteve rome, ashkallike dhe egjiptiane. Objektivi kryesor i projektit është promovimi i të drejtave të këtyre komuniteteve në Kosovë, me theks të veçantë në kthimin e tyre nga vendet e BE-së, si Gjermania, dhe lehtësimin e integritit të tyre në shoqërinë kosovare. Për ta realizuar këtë qëllim, projekti ka marrë përsipër përmirësimin e qasjes në arsim, punësim, shëndetësi dhe shërbime sociale në katër lagje në të dy komunat ku këto komunitete banojnë, si hap përpara drejt rritjes së pjesëmarrjes dhe integritit të tyre ekonomik dhe social.

Projekti ka katër fusha të ndërhyrjes, secila e përcaktuar si qëllim specifik i projektit:

1. Të sigurohet që fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë në katër lokacionet e synuara të kenë qasje të rregullt në arsim (niveli parashkollor, fillor dhe i mesëm i ulët).
2. Përmirësimi i shëndetit dhe cilësisë së jetës së pjesëmarrësve nga komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptiane.
3. Rritja e perspektivave të punësimit për komunitetet e synuara rome, ashkallike dhe egjiptiane, përfshirë familjet e kthyera.
4. Të forcohen kapacitetet e organizatave që ofrojnë shërbime të arsimit, shëndetësisë, mirëqenies

sociale dhe punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, dhe të avokohet për një pozitë më të mirë të këtyre komuniteteve në shoqërinë kosovare.

Grupi i synuar i Projektit Prospekti 3 përbëhet nga komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptiane në katër lagje në dy komuna, me rreth 2.200 banorë. Komunitetet e synuara janë në lagjen 7 Shtatori dhe në fshatin Vitomiricë të komunës së Pejës, si dhe në fshatrat Gelancë dhe Leshan në komunën e Suharekës. Secili nga këto katër lokacione ka një shkollë filllore që ofron arsim parashkollor për fëmijë dhe i ofron komunitetit shërbime arsimore. Projekti do të përfundojë në vitin 2023 dhe mbështetet nga Bashkimi Evropian.

Fillimisht ishte planifikuar që projekti të përfundojë më 30 tetor 2022. Megjithatë, ishte e nevojshme që projekti të vazhdojë edhe për 6 muaj, deri më 30 prill 2023. Në fazën e vazhimit, aktivitetet e projektit synojnë t'i rivendosin lidhjet ndërmjet institucioneve dhe anëtarëve të komunitetit, të cilat u ndërprejnë për shkak të pandemisë.

Gjatë vitit 2022, projekti ka realizuar një sërë masash dhe aktiviteteve në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit. Këto u kryen në bashkëpunim me grupet e synuara, OJQ-të partnere dhe palët përkatëse të interesit për të siguruar qëndrueshmëri pas përfundimit të projektit. Aktivitetet u realizuan në mbështetje të familjeve në komunitetet e pafavorizuara në pikëpamje ekonomike dhe sociale në fushat e: 1) arsimit, posaçërisht duke ofruar mbështetje intensive për mësim dhe aktivitete rekreative arsimore për fëmijët gjatë muajve të verës; 2) shëndetit, duke ofruar qasje në shërbimet shëndetësore për anëtarët e komunitetit, me fokus në gra dhe vajza; 3) punësimit, duke vazhduar përmirësimin e qasjes në platformën digjitale të punës dhe 4) aktivitetet e avokimit në komunat që mbulohen nga projekti.

Me fillimin e vitit të ri shkollor, KFOS-i, përmes partnerëve lokalë, ka filluar punën në dy grupe të aktiviteteve: në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe në aktivitete ndërkulturore. Për sa u përket aktiviteteve ndërgjegjësuere, partnerët lokalë kanë filluar fushata ndërgjegjësuere për ta promovuar pjesëmarrjen dhe regjistrimin e rregullt të fëmijëve në klasën e parë. Ata kanë filluar t'i vizitojnë shtëpitë dhe të organizojnë takime me prindër, shpesh duke përfshirë zyrtarë të arsimit nga komuna. Ata gjithashtu kanë përgatitur dhe shpërndarë materiale ndërgjegjësuere, përfshirë informacione për kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen

gjatë pandemisë. Për sa u përket aktiviteteve ndërkulturore, që synojnë uljen dhe eliminimin e paragjytimeve dhe stereotipave, partnerët lokalë kanë filluar të zhvillojnë aktivitete që i bashkojnë fëmijët e komuniteteve të ndryshme për t'i kuptuar traditat kulturore të njëri-tjetrit përmes lojërave, garave të ndryshme, artit etj. Për t'u ndihmuar fëmijëve nga komunitetet që kanë vështirësi në mësimnxënie, të rinjtë e komunitetit kanë filluar t'u ndihmojnë fëmijëve nga komunitetet që kanë vështirësi në mësimnxënie, duke i përgatitur ata për punë me fëmijë dhe duke u ndihmuar në detyra të shtëpisë.

The amount of grants and expenses for KKS project in 2022

Titulli i projektit	Përshkrimi	Shuma në Euro
Prospect 3	OJQ "Nevo Koncepti", OJQ "Syri i Vizionit" implementimi i aktiviteteve arsimore, ndërmjetësimi shëndetësor dhe social, dhe rrjetëzim dhe avokim, si dhe shpenzime të aprovuara nga donatori.	97,999.91



Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur